KRONIKË E ZEZË

Arrestohen 2 të dyshuar, në vitin 2021 grabitën para nga furgoni i një banke

17 janar 2023, 12:44

Shpërndaje në

Policia e Kosovës ka njoftuar se të martën ka arrestuar dy persona të dyshuar për përfshirjen në një grabitje të armatosur që ka ndodhur në nëntor të vitit 2021.

Sipas njoftimit të Policisë janë arrestuar A.B. (1982) dhe V.S. (1992). Ata dyshohet se në bashkëpunim me katër të dyshuar të tjerë, nën kërcënimin e armës, kanë grabitur një shumë të konsiderueshme parash nga një furgon i një kompanie për transportimin e parave të një banke.

Rasti ka ndodhur në fshatin Parallovë në rrugën Gjilan-Prishtinë.

"Është arritur të sigurohen prova se të njëjtit me datën 18.11.2021 në bashkëveprim edhe me katër të dyshuar të tjerë të arrestuar më herët kanë qenë të përfshirë në një grabitje të armatosur e ndodhur në fshatin Parallovë në rrugën Gjilan-Prishtinë. Në këtë rast të dyshuarit e lartcekur duke përdorur armë zjarri të llojit AK/47 kishin shtënë në drejtim të një kombi të një kompanie për transportimin e parave të një banke, duke arritur të grabisin një shumë të konsiderueshme parash", thuhet në njoftimin e Policisë.

Gjatë kontrollit thuhet se në shtëpitë dhe objektet përcjellëse të dy të dyshuarve janë gjetur dhe konfiskuar si prova materiale për gjykatën: një pistoletë e llojit TT, dy karikatorë të armës së njëjtë, trembëdhjetë copë fishekë të kalibrit 7.62 mm, para në vlerë 2600 euro, dy karikatorë të zbrazët të armës AK/47, një kondak i armës AK/47, trembëdhjetë copë fishekë të armës AK/47 si dhe gjatë copë gëzhoja të kalibrit 7.62 mm. të pushkës automatike.

"Pas arrestimit të dyshuarit janë intervistuar në prani të avokatëve mbrojtës. Nga Prokurori i Shtetit ndaj të dyshuarve është lëshuar masa e ndalimit për 48 orë dhe ndaj tyre do të ngritët kallëzim penal për veprat penale 'Grabitje' dhe 'Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve' dhe rasti do të procedohet në Prokurorinë Themelore", thuhet në njoftimin e Policisë.

© KOHA. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara.

Komento

#PARA #GRABITEN #FURGONI #BANKA #ARRESTOHEN #DY TE DYSHUAR

Katër të arrestuar pasi rrahën një person në Klinë
Një person vdiq papritmas në një kafene në Prizren
Tejkaloi në vijë të plotë, vozitësit nga Kamenica i merret patenté shoferi
Tetë vjet burgim për të akuzuarin për grabitje dhe mbajtje të paautorizuar të armëve
Aktakuzë ndaj 6 personave për vrasjen e 23-vjeçarit në Mirushë
Gruaja rrah bashkëshortin në Prishtinë, viktima merr trajtim mjekësor
Malaziasi tenton t'ia japë 5 euro ryshfet policit kosovar, arrestohet

YouTube
Privacy

Taboola Feed

Kolltuk masazhues profesional - 73% zbritje! Vetëm 55 000 Lek
megazbritje.al | Sponsored


Fertility Clinics Might Be Better Than You Think
Sponsored Listings | Sponsored

Tifozët reagojnë pasi Arteta vrapoi për ta ndalur Xhakën
Londër, 16 janar – Tifozët mbetën të habitur derisa shikuan trajnerin e Arsenalit, Mikel Arteta, derisa ndiqte Granit Xhakën, për të penguar até që të përplaset me lojtarët e Tottenhamit. …
Kohanet

A Truck Driver's Salary in USA Might Surprise You
Truck Driving Jobs USA | Search Ads | Sponsored

TË TJERA

Burri nga Podujeva e raporton nipin për vjedhje

Godet këmbësoren me veturë, arrestohet i dyshuari dhe dërgohet në mbajtje

Tre persona e grabitin një veturë nën kërcënim të armës, aksidentohen me të

Dy të lënduar në aksidentin në Shakovicë

Kjo faqe kontrollohet dhe menaxhohet nga KOHA. Të gjitha materialet në të, përfshirë fotografitë, janë të mbrojtura me copyright të KOHA-s dhe për to KOHA mban të drejtat e rezervuara. Materialet në këtë faqe nuk mund të përdoren për qëllime komerciale. Ndalohet kopjimi, riprodhimi, publikimi i paautorizuar qofshë origjinal apo i modifikuar në çfardo mënyre, pa lejen paraprake të KOHA-s. Shfrytëzimi i materialeve nga ndonjë faqe interneti a medium tjetër pa lejen e Grupit KOHA, në emër të krejt njësive që e përbëjnë (Koha Ditore, KohaVision, Koha.net, Botimet KOHA, KOHA Print dhe ARTA), është shkelje e drejtave të autorit dhe të pronës intelektuale sipas dispozitave ligjore në fuqi. Të gjithë shkelësit e këtyre të drejtave do të ballafaqohen me ligjin.